REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Durrës 28.10.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si më poshtë:

Në vijim të ankesës suaj lidhur me praninë e qenve endacakë në zonën e Vollgës, përballë Sfinksit , ju bëjmë me dije se rasti është verifikuar në terren nga strukturat e Shërbimit Veterinar, pjesë e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Emergjencave Civile pranë Bashkisë Durrës.

Gjatë verifikimit në terren u konstatuan dy qen, të cilët rezultojnë të vaksinuar dhe të matrikulluar. Gjithashtu, u konstatua se për këto kafshë kujdesen edhe banorë e subjekte të cilët ushtrojnë aktivitet në këtë zonë.
Në momentin e verifikimit, të dy qentë u konstatuan të qetë, pa shfaqur sjellje agresive apo elementë të tjerë që të përbënin rrezik të drejtpërdrejtë për qytetarët.
Për sa më sipër, bazuar në gjendjen faktike të konstatuar nga strukturat përgjegjëse, nuk u evidentua një situatë që të kërkonte ndërhyrjen për kapjen dhe largimin e tyre nga zona.
Në kushtet kur Bashkia Durrës aktualisht nuk disponon një strehë të posaçme për qentë endacakë, menaxhimi i tyre është realizuar në bashkëpunim me organizatat dhe shoqatat që veprojnë në këtë fushë, duke zbatuar metodën Kap–Sterilizo–Vaksino–Lësho (CNVR). Kjo metodë synon kontrollin dhe reduktimin gradual të popullatës së qenve endacakë, duke parandaluar shumimin e pakontrolluar të tyre.
Strukturat e Shërbimit Veterinar do të vijojnë monitorimin e situatës dhe, në rast se evidentohen problematika konkrete, si sjellje agresive, rrezik për qytetarët, kafshë të sëmura apo të dëmtuara, do të ndërmerren masat përkatëse në përputhje me procedurat dhe legjislacionin në fuqi.
Bashkengjitur po ju dergojmë një video të inspektimit të zonës.